



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE GJIROKASTËR

NOTER VANGJELI S. MARKO  
ADRESA 18 SHTATORI, 18 SHTATORI  
TEL: 694008820

## VENDIM PËR LËSHIMIN E DËSHMISE SË TRASHËGIMISË LIGJORE

Nr. repertori: 538

Nr. koleksionit: 191

Gjirokaster më 25/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2021021790021573565

DATE 25/02/2021

NR REP 538

NR KOL 191



A2021021790021573565

**LËSHIMI I DËSHMISË  
SË TRASHËGIMISË LIGJORE**

TAKSA E PULLES  
U APLIKUA NE  
KOPJENE NOTERIT

Sotë më datë 25.02.2021, para meje Noter VANGJELI S. MARKO, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore GJIROKASTËR, me zyrë në adresën Gjirokaster, 18 SHTATORI, 18 SHTATORI, u paraqit personalisht:

**KËRKUES/IT:**

Nimerald Llano, atësia Petrit, amësia Liliana, shtetas Shqiptar, lindur në Përmet dhe banues në GJIROKASTËR, me adresë Doktor Vasil Laboviti 01980029; Nd. 1; H. 7; Ap. 8; Gjirokastër; Gjirokastër; 6001; Gjirokastër, lindur më 01/02/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035320762 dhe nr. personal H80201033C .

**OBJEKTI:**

Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin Petrit Llano, me atesi Nimet dhe amesi Paquze, lindur ne Gjirokaster, me datelindje 01.12.1947, me banim ne Gjirokaster dhe vdekur me 29.10.2008

**BAZA LIGJORE:** Nenet 316, 317, 318, 348, 360, 361 e vijues i ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet, neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

Pasi administrova në tërësi provat shkresore të prezantuara nga kërkuesi dhe dëgjova pretendimet e tij, Unë Noteri/ja kryesisht, bazuar në nenin 111, 113 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj e në prova të kërkesës, verifikova dhe konstatova se kjo çështje hyn në kompetencën e Shërbimit Noterial, të Degës Vendore Gjirokaster, përkatësisht Noter VANGJELI S. MARKO, me zyrë Noterie në Gjirokaster, 18 SHTATORI, 18 SHTATORI, territor mbi të cilën shtrin kompetencën kjo zyrë për shqyrtimin e kësaj kërkesë. Në këto kushte,

**VËREJ SE:**

Kërkuesi **Nimerald Llano** ka bërë kërkesë me objekt "Lëshim i dëshmisë së trashëgimisë ligjore për babain e tij, të ndjerin Petrit Llano, me atesi Nimet dhe amesi Paquze, lindur ne Gjirokaster, me datelindje 01.12.1947 me banim ne Gjirokaster dhe vdekur me 29.10.2008.

Nga kërkimi pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë konform ligjit nr. 110/2018 "Per noterinë" nuk rezultoi që trashgimlënësi të ketë lënë testament për të gjithë pasurinë e tij ose për një pjesë të trashëgimisë.

Në këto kushte ka vend për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore konform nenit 317 të Kodit Civil "Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënësi nuk ka bërë testament ose ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij ....."

Nga pikëpamja e kopetencës territoriale, referuar nenit 348 të Kodit të Civil, paragrafi i dytë vërtetohet se trashëgimlënësi ka jetuar në Gjirokastër "...dëshmia e trashëgimisë lëshohet nga noteri



Fq. 1



A2021021790021573565

i njësisë vendore ku ka patur vendbanimin e fundit trashëgimlënësi...”, e si rrjedhojë unë noterja Vangjeli S. Marko kam kompetence ligjore dhe tokesore per celjen e dëshmisë së trashëgimisë në emër të trashëgimlënësit **Petrit Llano**.

Vdekja e trashëgimlënësit më datë 29.10.2008 vërtetohet sipas Certifikatës datë 29.01.2021 të lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile Gjirokastër.

Në zbatim të nenit 318/2 Kodit Civil të RSH “Trashëgimia celet sipas ligjit të kohës kur është celur”, ligji material që do të zbatohet në këtë rast është “Kodi Civil i RSH” i miratuar me ligjin nr. 7850 datë 29.07.1994 i ndryshuar.

Nga aktet e administruara në dosje me kërkues **Nimerald Llano** rezulton se trashëgimlënësi Petrit Llano nga martesë me Liliana Llano kanë lindur 2 fëmijë.

Fëmijet dhe bashkeshortja janë trashëgimtare ligjore të rradhës së parë përcaktuar sipas neneve 360 e 361 të Kodit civil ku përcaktohet: “Trashëgimtarët ligjorë janë fëmijët, fëmijët e fëmijëve.....”; “Në rradhë të parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta”

*Nga aktet e paraqitura dhe shpjegimet e kërkuesit rezulton se:*

Trashëgimlënësi nuk ka fëmijë të paravdekur.

Trashëgimtarët nuk kanë hequr dorë nga trashëgimia.

Trashëgimtarët nuk e kanë humbur zotësinë për të trashëguar.

Nuk rezulton që trashëgimtarët të jenë shpallur të padenjë.

Nuk ka pasur fëmijë të lindur nga martesë të tjera.

Trashëgimtarët që përcaktohen në këtë akt janë të detyruar të përgjigjen për detyrimet dhe shpenzimet që rëndojnë mbi pasurinë trashëgimore në përpjestim me pjesën takuese deri në vlerën e plotë të pasurisë trashëgimore.

**Dokumentat provuese janë:**

Çertifikatë vdekje e Petrit Llano, të lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile Gjirokastër. Çertifikatë familjare e vitit 1992, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Gjirokaster, Certifikate familjare viti 1950-1974, Çertifikatat personale të trashëgimtarëve, Certifikate martese.

### PËR KËTO ARSYE:

**Bazuar në nenet: 316, 317, 318, 320, 348, 360 e vijues të Kodit Civil, dhe neni 61, pika 1, shkronja d, j; nenet 97, 111, 112, 113 e vijues të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për noterinë”;**

### V E N D O S A:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin **Petrit Nimet Llano**, duke caktuar si trashëgimtarë ligjorë të rradhës së parë:

**Liliana Llano**, e bija e Dane, gjinia femer, e ve, lindur në Gjirokaster dhe banues në Gjirokaster, e datëlindjes 01.06.1954, me shtetësi shqiptare, identifikuar me kartë ID nr. personal F45601092G, **bashkeshorte e trashëgimlënësit;**

**Palmina Llano**, atësia Petrit, amësia Liliana, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokaster dhe banuese në Gjirokaster, lindur më 19.10.1988, gjendja civile beqare, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim nr. personal I86019082L, **e bija e trashëgimlënësit;**

  
 Fq. 2



A2021021790021573565

**Nimerald Llano**, atësia Petrit, amësia Liliana, shtetas Shqiptar, lindur në Përmet dhe banues në GJIROKASTËR, lindur më 01/02/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim nr. personal H80201033C, **i biri i trashëgimlënësit;**

të cilët trashëgojnë në mënyrë të barabartë nga **1/3 (një të tretën) pjesë** të pasurisë trashëgimore të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe detyrimet përkatëse të trashëgimlënësit.

3. Kërkuesi mori dijeni dhe iu sqarua nga Noteri detyrimi ligjor për depozitimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor prej 30 (*tridhjetë ditë kalendarike*), nga data e lëshimit të saj. Në rast të kundërt, për çdo ditë vonesë, aplikohen penaltet përkatëse sipas dispozitave ligjore në fuqi, referuar nenit 25, pika 2 e ligjit 111/2018 "Për Kadastrën".
4. **Dëshmia e trashëgimisë, pavarësisht rrethit të trashëgimtarëve në çastin e regjistrimit pranë institucionit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, nuk mund të cënojë pjesën e bashkëshortit të prezumuar bashkëpronar për pasuritë e përfituara përgjatë martesës. Nëse trashëgimlënësi ka pasuri bashkëshortore të përfituara përgjatë martesës, por të regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, vetëm në emrin e tij, regjistrimi i pjesës takuese të trashëgimisë ligjore do të bëhet duke zbritur 1/2 pjesë të prezumuar të bashkëshortit pasjetues, në referim me nenin 76 të Kodit Civil, nenit 112, pika e ligjit 110/2018 "Për Noterinë". Gjithashtu nëse trashëgimlënësi është i prezumuar bashkëpronar në ndonjë nga pasuritë e regjistruara në institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, atëherë, pjesa e prezumuar e bashkëpronësisë së tij do të kalojë tek trashëgimtarët ligjorë sipas pjesëve takuese. Bashkëlidhur certifikata e martesës, referuar nenit 112, pika 3 e ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".**
5. Shpenzimet Noteriale i ngarkohen kërkuesit.
6. Kjo dëshmi trashëgimie përbëhet nga 3 (*tre*) fletë dhe lëshohet në kopje origjinale nga të cilët, njëri depozitohet në arkivin e zyrës noteriale, nga një kopje i dorëzohet kërkuesit për ta paraqitur në institucionet përkatëse (për aq pasuri sa disponon) dhe nga një kopje u jepet trashëgimtarëve ligjorë.
7. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave Personale*", unë Noteri/ja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj dëshmie, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.
8. Kundër këtij vendimi për lëshim dëshmi trashëgimie ligjore, mund të bëhet ankim në Gjykatën kompetente, sipas rregullave për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

**Dëshmia e trashëgimisë ligjore lëshohet në Gjirokastrë, sot më datë 25.02.2021**

**NOTER**

**VANGJELI S. MARKO**

